

VENDIM
Nr. 22, datë 24.4.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË KLIENTIT PËR REZIDENCAT
STUDENTORE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 28 dhe 29 të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 24.4.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Miratimi i projektvendimit: “Për përcaktimin e kategorisë së klientit për rezidencat studentore publike””,

Vëren se:

1. Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare nr. 2” sh.a., me anë të shkresës nr. 699 prot., datë 10.8.2018, me lëndë: “Kërkesë për rishikimin e çmimit të ujit”, si dhe shkresës nr. 817 prot., datë 6.11.2018 me të njëjtën lëndë ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Ujit (ERRU) kërkesën për ndryshimin e kategorisë së konsumatorit nga “Ent Privat” në “Ent Publik” në marrëdhënie me shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a..

2. Në pikën 2.9 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjiellës kanalizimeve sh.a.”” (Kodi i Ujit) përcaktohen kategoritë e konsumatorëve në sektorin ujësjiellës kanalizime, ku përfshihen konsumatorët familjarë, entet publike dhe entet private.

3. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) me anë të vendimit nr. 4, datë 29.2.2012, “Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë”, i ndryshuar me vendimin e KKRR nr. 31, datë 27.4.2018, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 4, datë 29.2.2012, “Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë”” (Vendimi i KKRR nr. 4, datë 29.2.2012, i ndryshuar) ka përcaktuar kategorinë në të cilën do të përfshihen disa klientë të veçantë të shoqërive ujësjiellës kanalizime si: ambasadat, konsullatat, rezidencat diplomatike, selite e partive politike, selitë e komuniteteve fetare, objektet e kultit dhe shoqëritë tregtare shtetërore.

4. Gjithashtu në nenin 1 të vendimit të KKRR nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi i KKRR nr. 39) dhe në nenin 1 të vendimit të KKRR nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42 i KKRR) janë përcaktuar përkufizimet e kategorive të klientëve në sektorin Ujësjiellës Kanalizime, ku me “Konsumatorë publik” nënkuptohet: çdo person/subjekt ligjor të klasifikuar si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare (ambasada, konsullata dhe rezidenca diplomatike), selitë e partive politike dhe degëve të tyre si dhe çdo institucion i cili kryen aktivitete me interes të përbashkët ose publik që nuk është regjistruar si organizatë fitimprurëse, ndërsa me “Ent privat” nënkuptohet: çdo person/subjekt ligjor ose organizatë fitimprurëse që ushtron veprimtari tregtare apo industriale të çfarëdo lloji përfshirë edhe shoqëritë tregtare shtetërore (KESH sh.a., Ndërmarrjet e trajtimit të studentëve e të tjera të ngjashme).

5. Nevoja e ndryshimit të kategorisë së klientit nga “Klient privat” në “Klient publik” në marrëdhënie me shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime nga ana e Rezidencës Studentore nr. 2 Tiranë, argumentohet:

a) Shoqëria Rezidenca Studentore nr. 2, Tiranë, është një shoqëri tregtare me kapital publik e organizuar në formën e shoqërisë aksionare dhe ka si aksionar të vetëm Bashkinë Tiranë. Objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqërie publike është trajtimi i studenteve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Mjekësisë, Infermierisë dhe Universitetit të Sporteve, Tiranë me fjetje dhe ushqim.

b) Shoqëria Rezidenca Studentore nr. 2, Tiranë, subvencionohet nga Buxheti i Shtetit për përballimin e kostove të veprimtarisë së saj por ende nuk arrihet mbulimi i plotë i tyre. Megjithatë Rezidenca Studentore nr. 2, Tiranë, shlyen në mënyrë të rregullt faturat e konsumit të ujit.

c) Shoqëria Rezidenca Studentore nr. 2, Tiranë, vlerëson ndryshimin e kategorisë së klientit nga “Klient privat” në “Klient publik”, si një mënyrë që do të ndikonte në uljen e kostove, veçanërisht në kushtet kur rikonstruksioni i disa godinave të saj e ka rritur ndjeshëm përdorimin e ujit jo vetëm për pirje dhe higjienë por edhe për ngrohje, duke rritur kostot e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

6. Referuar kërkesës së Rezidencës Studentore nr. 2, Tiranë, dhe duke vlerësuar situatën e rezidencave studentore publike në vend, rezulton se:

a) Në 6 qytete në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin rezidenca studentore publike, për akomodimin e studenteve që ndjekin studimet e larta pranë Universiteteve publike;

b) Ndonëse rezidencat studentore janë të regjistruara si shoqëri tregtare me kapital publik, marrësit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura në godinat e rezidencave studentore publike janë studentë të universiteteve publike, kategori kjo e cila duhet të mbështetet në drejtim të lehtësimit të ngarkesës së detyrimeve gjatë periudhës së ndjekjes së studimeve;

c) Pavarësisht se palët në kontratën për shërbimin ujësjellës kanalizime janë Shoqëria Ujësjellës Kanalizime dhe Shoqëria e Rezidencës Studentore, tarifën e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura e paguajnë studentët sepse ata janë përdoruesit e këtyre shërbimeve. Tarifat e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura përcaktohet nga ERRU dhe asnjë palë përveç shoqërisë së licencuar ujësjellës kanalizime nuk ka të drejtë të ofrojë këtë shërbim, pasi sipas përcaktimeve ligjore rishitja është e ndaluar;

d) Ndryshimi i kategorisë së klientit për rezidencat studentore nga klient privat në klient publik ka efekt financiar të ulët në të ardhurat e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe nuk ndikon aktivitetin e tyre;

e) Ulja e kostove të ushtrimit të aktivitetit për rezidencat studentore publike në vend do të sjellë mundësinë e përmirësimit të shërbimit ndaj studentëve, pa cenuar aktivitetin normal të shoqërive ujësjellës kanalizime.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi se ndryshimi i kategorisë së klientit për rezidencat studentore publike në vend ndikon në uljen e kostove të funksionimit të tyre, sjell mundësinë e rritjes së cilësisë së shërbimit që do të marrin studentet e institucioneve të arsimit të lartë publik që akomodohen pranë këtyre rezidencave, nuk cenon funksionimin normal të shoqërive ujësjellës kanalizime, si dhe duke vlerësuar se ky ndryshim është në përputhje me ligjin nr. 8102 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Rezidencat Studentore Publike në të gjithë vendin klasifikohen si klientë publik në marrjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura nga shoqëritë ujësjellës kanalizime.

2. Në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 4, datë 29.2.2012, “Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë”, në pikën 1/d togfjalëshi “Ndërmarrjet e Trajtimit të Studenteve”, hiqet.

3. Në nenin 1 të vendimit të KKRR nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, në përkufizimin “Ent privat”, togfjalëshi “Ndërmarrjet e trajtimit të studentëve”, hiqet.

4. Në nenin 1 të vendimit të KKRR nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, në fund të përkufizimit “Konsumator publik”, shtohet togfjalëshi “..si dhe Rezidencat Studentore Publike”.

5. Në nenin 1 të vendimit nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” në përkufizimin “Ent privat”, togfjalëshi “Ndërmarrjet e trajtimit të studentëve”, hiqet.

6. Në nenin 1 të vendimit të KKRR nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të

ndotura”, në fund të përkufizimit “Konsumator publik”, shtohet togfjalëshi “..si dhe Rezidencat Studentore Publike”.

7. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit për njoftimin e shoqërive ujësjellës kanalizime për marrjen e këtij vendimi.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë ujësjellës kanalizime që kanë si klientë të tyre rezidenca studentore publike.

9. Efektet financiare fillojnë në datën 1.6.2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani